

## **UNESCO Heritage**

### **Butrinti**

National Park of Butrint. Declared "Monument in Protection" by the Albanian State in 1948. Registered as an UNESCO world heritage in 1992. Inclusion in the List of Monuments at Risk in 1997. It was further expanded in 1999.

The national importance of Butrint's assets and cultural heritage was recognized and confirmed in the world by UNESCO World Heritage Committee in 1992. Registration of Butrint by UNESCO was based on cultural criteria as a unique and exceptional testimony of a cultural tradition and civilization that disappeared.

Butrint was an ancient city in Epirus, during the VII century. The main objects in Butrint are: The Temple of Aeskulapius, the theatre with 1500 seats, nymfeu, bathrooms, basilica, the Lion gate, the gate lake, the Venetian towers and the fortress of Ali Pasha etc. A series of items can be found at the Museum of Butrint.

### **Gjirokastra**

The museum City of Gjirokastra. Declared as a "Museum City" by the Albanian state in 1961. Declared as a world heritage in 2005. Gjirokastra is a unique testimony of a cultural tradition of life during the XIV - XIX centuries.

It is the main city of the southern part of the country. This city impresses everyone who visits it, as a result of the architecture, the surprising images of Drinos valley, and the spectacular crown ridge of calcareous Bureto and Lunxhëria.

### **Berati**

Registered as a world heritage in 2005 and ratified in 2008. Berati is the city where can be found traces of the Illyrian, Roman, Byzantine and Ottoman periods, rich in old churches with wonderful wall paintings, icons and wood engraving. In 1961 the city was put under the protection of the Albanian state and was declared a "Museum City".

### **Albanian iso- polyphony**

Albanian Folk Iso-polyphony is proclaimed "masterpiece of the oral heritage of humanity" protected by UNESCO. Obviously, the date November 25, 2005 is a historic day for the entire Albanian cultural heritage but also for Albania itself. In this day "Albanian folk iso-polyphony" was added to the list of "Masterpieces of the oral heritage of humanity" protected by UNESCO, a fact that was heralded in all media world by Dr. Koichiro Matsura, General Director of UNESCO, the UNESCO headquarters in Paris. To come up with this decision, the International

Jury meeting in Paris from 21-24 November 2005, examined 60 candidates proposed for inclusion in the list "Masterpiece of Humanity", the proposals were made in an official way by different countries of the world and met the criteria stated files for this purpose.

In recent years, in the field of international recognition of cultural heritage were included: Butrint National Park, the city of Berat and Gjirokastra, as "cultural heritage of humanity" protected by UNESCO.

Albanian state itself has developed and implemented the law in this area that has also become part of global standards, though adopting almost all the international conventions in this field.

## Vëndet në UNESCO

### Butrinti

Ndër më të rëndësishmit janë rrënojat e qytetit antik të Butrintit, i cili ndodhet nën mbrojtjen ndërkombëtare të UNESCO-s. Butrinti gjendet në skajin jugor të liqenit të Butrintit ( në antikitet i njohur me emërtimin Pelodës) në një distancë prej 18 km larg nga qyteti i Sarandës. Ai është një prej pikave më të rëndësishme arkeologjike të Shqipërisë. Butrinti ishte një qytet i lashtë në Epir që përmendet që në shek.VII B.C. si një qëndër e fortifikuar. Krahas statusit të UNESCO-s që prej vitit 2000 Butrinti është shpallur gjithashtu Park Kombëtar. Objektet kryesore për tu vizituar Butrinti janë Tempulli i Aeskulapiusit ( Perëndia e shëndetit) shek II A.D. , theatri me 1.500 vende (shek III B.C), pagëzorja e cila është një monument paleokristian dhe për nga madhësia është e dyta pas asaj së Shën Sofisë në Stamboll, nymfeu, banjat, bazilika, porta e Luanit, porta e liqenit ,kulla Veneciane, kalaja e Ali Pashait etj. Një seri objektesh gjenden në Muzeun e Butrintit.

### Gjirokastra

Qytet i përfshirë në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s më 2005, si një nga pak shembujt e mbijetuar në Ballkan të qyteteve tregtare të stilit otoman. E vendosur në Shqipërinë jugore, Gjirokastra qëndron në shpatet e pjerrëta të luginës së lumit Drino, në një pozicion mbisundues mbi një peizazh të pasur me histori, kufijtë e të cilit përvijohen nga maja malesh të larta. Ky është “qyteti i një mijë shkallëve” që përfshin qindra shtëpi-kullë të tipit otoman me çatitë dalluese të gurta, ballkonet e drunjta dhe muret e gurta herë-herë të zbardhura me gëlqere.

### Berati

Në datën 8 Korrik te vitit 2008 Berati u rregjistrua në Listën e UNESCO-s nga Komiteti i Trashëgimisë Botërore në Konferenën e rradhës të mbajtur në Kanada. Berati u vlerësua si një shembull i rrallë i arkitekturës tipike Osmane.

Berati u përket qyteteve të rrallë ku jeta fillon qysh në lashtësinë e thellë dhe vazhdon pa u ndërprerë deri më sot. Dy çekanë guri e datojnë fillimin e jetës në të para Periudhës së Bronzit (2600-1800 P.Kr.). Dëshmitë arkeologjike tregojnë se në shek. VII-VI P.Kr. Këtu është zhvilluar një vendbanim paraqytetar, me punishtet e tij të qeramikës dhe me një jetë shoqërore të diferencuar. Në vitin 1961 Berati u shpall zyrtarisht qytet muze. Ai është qytet muze me pasuri të konsiderueshme monumentesh dhe me vlera të larmishme për nga gjinitë, të cilat përbëjnë një dëshmi të trashëgimisë kulturore, historike e artistike, të jetës e të punës, të realizuara mjeshtërisht brez pas brezi nga banorët e tij. Nga zonifikimi dhe nga përcaktimi i kategorisë së monumenteve qyteti ndahet në tri zona : zona muze, zona e mbrojtur dhe zona e lirë.

## **ISO polifonia Shqiptare**

Iso-polifonia popullore shqiptare, shpallet “Kryevepër e trashëgimisë gojore të njerëzimit”, mbrojtur nga UNESCO.

Pa më të voglin dyshim, data 25 nëntor 2005 është një ditë historike për mbarë trashëgiminë kulturore të shqiptarëve por dhe për vetë Shqipërinë. Në këtë ditë “Iso-polifonia popullore shqiptare” futet në listën e “Kryeveprave të trashëgimisë gojore të njerëzimit” mbrojtur nga UNESCO, fakt që u kumtua në të gjitha mediat e botës nga Dr. Koichiro Matscuro, Drejtor i Përgjithshëm i UNESCO-s, nga selia qendrore e UNESCO-s në Paris.

Për të dalë me këtë vendim, Juria Ndërkombëtare e mbledhur në Paris nga data 21-24 Nëntor 2005, shqyrtoi mbi 60 kandidatura të propozuara për t’u përfshirë në listën “Kryevepër e njerëzimit”, propozime të bëra në rrugë zyrtare nga shtete të ndryshme në çdo anë të botës duke plotësuar dosjet dhe kriteret e shpallura për këtë qëllim.